



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 28. 09. 2011, në orën 10.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Ismet Beqiri, Kymete Bajraktari, Biserka Kostiq dhe Justina Pula.

Munguan: Duda Balje dhe Rita Hajzeraj.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi- OSBE, Uke Gashi- ZPRK dhe Visar Bivolaku-EUSR.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali – kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 13 shtator 2011,
3. Shqyrtimi i raportit mbi monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje (të punuar nga deputetja Albana Gashi).
4. Caktimin e datës rreth marrjes së qëndrimit lidhur me peticionin e ushtruar nga koalicioni ad-hoc lidhur me Projektligjin për qendrën historike të Prizrenit.
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 13 shtator 2011

Kryetarja – *Tha se kishte disa vërejtje në procesverbal në fjalimin e saj, por ato vërejtje janë përmirësuar me kohë në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën serbe nuk ka pasur kohë të bëhet përkthimi dhe kërkoj nga administrata që këto përmirësime të bëhen edhe në gjuhën serbe.*

Biserka Kostiq- *Tha se ka vërejtje dhe kërkoj që fjalina e parë e fjalimit të saj të hiqet.*

Kryetarja *konstatoi se procesverbali i datës 13 shtator 2011 u miratua me vërejtjet që u bënë.*

3. Shqyrtimi i raportit mbi monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje (të punuar nga deputetja, Albana Gashi).

Kryetarja- *Tha se draft- raportin e keni marrë me kohë, me siguri e keni analizuar dhe ftojme deputeten Albana Gashi, e cila ka punuar për monitorimin e këtij ligji që ta prezantojë një përmbledhje të këtij raporti se çka përmban.*

Albana Gashi- *Tha se rreth monitorimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje kemi kryer disa aktivitete, monitorimi është bërë në dy procese, takimet zyrtare me institucionet dhe vizita nëpër terren, organizimi i dëgjimit publik dhe raportimi në mbledhje të Komisionit i asaj se çka është bërë, pra kjo që po bëjmë sot.*

Kemi pasur vizitë në stacionin policor në Mitrovicë dhe në një strehimore, vizitë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, dhe takime me institucionet e tjera relevante përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Të gjitha vërejtjet i kemi përfshirë në këtë raport. Në fund kemi dhënë rekomandimet të cilat i kemi gjetur nga takimet që kemi pasur dhe dëgjimin publik. Unë ju lus që nëse ju si anëtarë të Komisionit keni vërejtje dhe ndonjë rekomandim shtesë, do ta përfshijmë në këtë raport.

Kryetarja- *Tha se falënderoj deputeten Albana Gashi për punën që e ka bërë lidhur me monitorimin e këtij ligji. Në këtë raport duhet ta miratojmë në Komision dhe ta procedojmë me tutje. Mirëpo meqenëse të gjithë anëtarët e Komisionit nuk paskan arritur ta marrin raportin me kohë, ne mund ta miratojmë në parim këtë raport.*

Ismet Beqiri- *Propozoj që raporti të miratohet në parim, nëse dikush ka vërejtje, ose rekomandime shtesë mund t'i sjellë me shkrim dhe të inkorporohen në raport.*

Justina Pula- *Tha se unë e përkrahu Albanën në punën, të cilën e ka bërë. Në të gjithë së bashku, tash duhet ta analizojmë këtë raport dhe të japim kontribut së bashku. Albana ka bërë një punë shumë të mirë, por tani na takon që të gjithë të kontribuojmë dhe ta*

plotësojmë të dalë një raport i kompletuar, se nuk i takon vetëm deputetes, sepse kjo nuk është punë shkencore, por një raport i monitorimit të ligjit.

Ismet Beqiri- Tha se raporti përmban pjesët kryesore, është raport përmbajtjesor, atë strukturën dhe formën se si duhet të duket kjo është punë që mund ta bëjë administrata. Unë prapë propozoj që raportin ta miratojmë në parim sot. Kush ka vërejtje dhe diçka shtesë le t'i sjellë me shkrim dhe le t'i bëhet renditja si duhet, dizajni, por nuk shoh asgjë e keqe që ne sot ta miratojmë në parim këtë raport.

Kryetarja- Tha se pajtohem me mendimet tuaja dhe e hedhim në votim. Në parim jam për raportin për monitorimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

P ë r f u n d i m

Kryetarja – Tha se konstatoj se te gjithë unanimisht e votuam këtë raport në parim, me vërejtjet që u bënë këtu. Kush ka vërejtje dhe ndonjë propozim shtesë le të paraqitet me shkrim.

4. Caktimin e datës rreth marrjes së qëndrimit lidhur me peticionin e ushtruar nga koalicioni ad-hoc lidhur me Projektligjin për qendrën historike të Prizrenit.

Kryetarja- Tha se të gjithë e dimë se këtë projektligj e kemi pasur në leximin e parë në seancë, nuk ka kaluar, vjen prapë në seancë në lexim të parë. Komisioni kompetent për shqyrtimin e këtij projektligji e ka refuzuar prapë, dhe tani e kemi një peticion prej dhjetëmijë nënshkrimeve. Ne duhet të vendosim për këtë peticion.

Ismet Beqiri- Jemi Komision kompetent për shqyrtimin e këtij peticioni. Unë i sugjeroj kryetares së Komisionit që të konsultohet me kryetarin e Kuvendit për këtë çështje, lidhur me procedurën. Kjo është një çështje e ndjeshme, është pjesë e pakos së Ahtisarit, është e drejtë e jona të vendosim si edhe Komisioni tjetër, por në fund është Kuvendi ai që vendos se çka të bëjë me atë projektligj.

Kurtan Kajtazi- Tha se çështja e ligjit është punë e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Ne mund ta analizojmë në aspektin e të drejtave të njeriut, të shikojmë ka shkelje të grupeve të caktuara, ose ka privilegje për grupe të tjera dhe t'ia procedojmë kryesisë si mendim tonin lidhur me peticionin.

Kryetarja- Tha se peticioni është kompetence e jona, sot pra lidhur me përmbajtjen e peticionit nuk do të vendosim, do ta analizojmë mirë përmbajtjen e peticionit. Kjo çështje do të jetë temë trajtimi në mbledhjen e radhës së Komisionit.

5. Të ndryshme

Albana Gashi- Tha se kam një kërkesë që lidhur me përgjigjen që po e bëjmë lidhur me shqyrtimin e kërkesave në Komision, a është e mundur që ato përfundime që u dërgohen palës ato t'i kemi edhe ne si anëtarë të Komisionit.

Kryetarja- Tha se konsideroj që është një kërkesë me vend dhe kërkoj nga administrata që ta kenë parasysh këtë kërkesë dhe në të ardhmen të veprojnë ashtu si u kërkua nga deputetja.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu